



## Sigurimi i Jetës për Kreditë Hipotekare

**Sigurimi i jetës per kredite hipotekare** mbron kredimarrësin në rastet kur shlyerja e kredisë bankare bëhet e pamundur për shkak të humbjes së jetës së kredimarrësit. Në këto raste shoqëria e sigurimit do t'i paguajë bankës, për llogari të Kredimarrësit, detyrimet e mbetura për kredinë e përcaktuar në policë pranë Alpha Bank Albania në kohën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

### Karakteristikat e Sigurimit të jetës së debitorit për kreditë hipotekare:

**Sigurimi i jetës se debitorit për kreditë hipotekare** mbron interesat financiare të kredimarrësit dhe trashëgimtarëve në rastet kur shlyerja e kredisë bankare bëhet e pamundur për shkak të humbjes së jetës së kredimarrësit brenda periudhës së kredisë, Shoqëria e Sigurimit do të paguajë pjesën e pashlyer të kredisë.

**I Siguruari** është kredimarrës i cili ka marrë kredi hipotekare pranë Alpha Bank nga mosha 18 - 70 vjeç.

**Shuma e sigurimit** është shuma fillestare e kredisë e përcaktuar në policën e sigurimit.

### Ngjarjet që sigurohen

- Humbja e Jetës
- Humbja Aksidentale e Jetës

**Primi i sigurimit** paguhet për kredimarrësin kryesor, çdo vit sipas përlllogaritjeve duke marrë në konsideratë moshën, gjininë, vlerën e mbetur të kredisë.

**Kohëzgjatja** e policës së sigurimit është për një vit dhe rinovohet çdo vit deri në maturimin e kredisë.

**Dëmshpërblimi** paguhet në vlerë monetare nga Kompania e Sigurimit me vërtetimi e ngjarjes së siguruar.

**Përfitimi i pagueshëm** - Shuma e mbetur e kredisë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, sipas tabelës së amortizimit të kredisë.

### Individë që nuk sigurohen:

- Bashkë kredimarrësit e tjerë të përfshirë në kredinë konsumatore (kur nuk kërkohet ndryshe)
- Ristrukturimin e kredisë së siguruar duke i ndryshuar afatin & kohëzgjatjen, sjell shfuqizimin e policës ekzistuese
- Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoja, sindroma organiko-cerebrale;
- Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- Individë mbi 70 vjeç dhe Individë më të rinj se 18 vjeç.

**Njoftimi i ngjarjes** duhet të kryhet me shkrim brenda **30 ditësh** nga data që Policëmbajtësi merr dijeni për ngjarjen.